



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BELSH

Belsh më: . 09 .2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - SHërbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: *“Hartim projekti për ndërtim dhe asfaltim i disa rrugeve te brendshme te Bashkise Belsh”*

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Shërbime per projektme teknike per ndertimin e vepra te ndertimit.

VLERA E FONDIT LIMIT: 9 540 973(nëntë milion e pesëqind e dyzet mijë e nenteqind e shtatedhjetë e tre) leke pa tvsh.

Përlllogaritja e fondit limit dhe specifikimeve teknike, termat e references, kriteret e vecanta te kualifikit është kryer nga Komisioni i ngritur me urdhër te titullarit nr. 3080 prot date 28.08.2025, referuar nenit 76 të pikës (a), nenit 11 të VKM-së me nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, që përcakton “çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj”,

Në bazë të nenit 21, pika 2, neni 35 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Belsh** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e fondit limit, termave te references dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Hartimi i dokumenteve të tenderit u bë në përputhje me Ligjin Nr. 162/2020 date 23.12.2020 “Për Prokurim Publik” i ndryshuar me Ligjin nr. 16/2024 për disa shtesa dhe ndryshime, si dhe VKM nr 285 date 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”(I ndryshuar). Kriteret e përgjithshme përmbajne listën e dokumentacionit, ligjor dhe administrativ, të kandidatëve/ofertuesve, që duhet të plotësojnë për të marrë pjesë në procesin e prokurimit, në përputhje me nenin 76 dhe 77 të LPP-së, nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”. Kriteret e përgjithshme për pranimin e operatorëve pjesëmarrës janë të pandryshueshme dhe janë vënë të njëjta me Dokumentet Standarde të Tenderit sipas Vendimit Nr. 02 Datë09.06.2021 te miratuara nga APP.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar me Ligjin nr. 16/2024 për disa shtesa dhe ndryshime, Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 82 “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”, si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 26. (ndryshuar me Vendimin Nr. 710, datë 24.11.2021; ndryshuar me Vendimin Nr. 498, datë 01.08.2024; ndryshuar me Vendimin Nr. 545, datë 04.09.2024)

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme, (sipas shtojcës 9).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenin 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2022-2023-2024**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vleres së fondit limit të kontratës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Shënim: “Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 41 pika 2 ku përcaktohet se: “Kërkesa të veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2 dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit

ekonomik dhe financiar i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 41 pika 2 ku përcaktohet se: "Kërkesateveçantatëkualifikimitduhettëpërfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së.

Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës" dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar, ku përcaktohet se "Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që është plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave" duke qenë se vlera e fondit limit të objektit përkatës është nën kufirin e ulët monetar kriteri hartohet në përputhje me vlerën procedurës. Referuar sa më sipër duke qenë se vlera e fondit limit objektin është nën kufirin e ulët monetar që i përket llojit të procedurës "Procedurë e hapur e thjeshtuar" edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi sipas përcaktimit të bërë në nenin 55 pika 4 e VKM Nr.285, dt.19.05.2021 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar).

2.2.2 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të maturuara të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025 sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" (i ndryshuar); prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës.

Shënim: Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr.10. Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit,** të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin...".

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 76, pika 2, e LPP, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5, pika c.

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2024 sipas kështeve prane bashkëve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për "Sistemin e Taksave Vendore"

i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohet dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, në një vlerë **jo më të vogël se 20%** të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet. Referuar sa më sipër dhe me qëllim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme. Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

Në nenin 55 “Procedurë e hapur e thjeshtuar” pika 4/b të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: 4. Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë: b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Njësia përcaktoj kriteret për furnizime të ngjashme si më lart duke qënë se këto kritere janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Sipas këtij neni, Njësia vlerëson se duhen kërkuar dokumentacioni ligjor sipas parashikimit të pikës 4/b të nenit 55 që provon kryerjen e furnizimeve të ngjashme.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë, Liçences profesionale për shoqërinë, sipas VKM nr. 943, datë 28.12.2016, e vlefshme për kategoritë në fushat e studimit dhe projektimit në ndërtim lëshuar nga MIE dhe/ ose MZHU dhe/ose nga cdo Institucioni i Autorizuar sipas legjislacionit

në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e studimit e projektimit në ndërtim , për këto kategori:

Kat. 6. -PROJEKTUES PER RRUGE

- a)-Projektim rruge lokale, rruge urbane dytesore dhe rruge interurbane dytesore.
- c) Shtresa rrugore e sistemim – asfaltime

Kat. 8. PROJEKTUES GJEODET

- a) Rilevime inxhinierike.
- c) Sistemet GIS.
- d) Bazamente gjeodezike

Kat. 9. PROJEKTUES GJEOLOG:

- d)Studim/vlersim gjeologo - inxhinierik i trojeve te buta dhe shpateve me qendrueshmeri te ulet.
- e)Studime e projekte hidrogeologjike.

Kat. 11. PROJEKTUES TE SINJALISTIKES RRUGORE:

- a)Projektim sinjalistike jondriçuese ne rruge lokale, rruge urbane dytesore, rruge interurbane dytesore, sheshe dhe parkime.

Kat. 12. STUDIME TË SIZMOLOGISË INXHINIERIKE

- b) - Studime/Vlersime te sizmiologjise inxhinierike per trojet ku ndertohen objekte te infrastruktures rrugore, etj.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016” (shënim- përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente. Licensat e mësipërme janë vendosur në kuadër të natyrës së përgjithshme të punimeve që priten të realizohen në këtë procedurë.

Duke u bazuar në: VKM Nr. 943, datë 28.12.2016, “Për miratimin e listës së profesioneve, kriterëve dhe procedurave për pajisjen me certifikatë profesionale dhe licencë në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit”; Ligjin Nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar me Ligjin Nr. 119/2020;

Projekti përfshin aksesin rrugor për disa zona/fshatra të bashkise Belsh. Kërkohet projektim i rrugëve dytësore ndihmëse, hyrje-dalje për automjete, rrugica industriale të brendshme, për funksionimin logjistik dhe ndërlidhjen me rrjetin rrugor. Projektimi i rrugëve të këtij niveli përbën objekt të veprave të infrastrukturës rrugore, dhe mund të kryhet vetëm nga subjekte të licencuara në kategorinë “a” të projektimit rrugor, sipas VKM 943. Dimensionimi i seksioneve të rrugës, profili gjatësor, kthesat, rrjedhja e trafikut të rëndë dhe sinjalistika kërkojnë një projekt të veçantë teknik, të përgatitur nga një inxhinier rrugësh me licencë për këtë kategori.

Më konkretisht, po paraqesim argumentimet si më poshtë:

KATEGORIA E KËRKUAR	PËRSHKRIMI I KATEGORISË	ARGUMENTIMI
6- a	Projektim rrugë lokale, rrugë urbane dytesore dhe rrugë interurbane dytesore.	Projekti përfshin aksesin rrugor për disa zona/fshatra të bashkisë Belsh. Kërkohet projektim i rrugëve dytësore ndihmëse, hyrje-dalje për automjete, rrugica industriale të brendshme, për funksionimin logjistik dhe ndërlidhjen me rrjetin rrugor.
6-c	Shtresa rrugore e sistemim – asfaltim	Punime për ndërtimin e shtresave rrugore, si: Niveli i nënbazës, Shtresa bazë (me material granulator ose stabilizues), Shtresat asfaltike (binder, asfalt i imët/final, etj.) Punime sistemimi të terrenit dhe shtresave rrugore për ndërtimin e rrugëve urbane, rurale apo autostrada. Punime asfaltimi dhe rehabilitimi rrugësh ekzistuese.
8 – a	Rilevime inxhinierike	Bazuar në termat e referencës, realizimi I ekspertizës së thelluar do të konsistoje në rilevimin e rrugës së subjektit I ekspertizës, si dhe matjet e devijimit vertical të elementeve strukturor nga goditjet sizmike apo difektet e realizimit të cilat ndikojnë drejtperdrejtë në efektin sizmik, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara. Projekti përfshin ndërtimin e rrugëve, gjë që kërkon: Matje topografike të detajuara të terrenit ekzistues, Ndërtimin e rrjetit të pikave referuese gjeodezike dhe Trasimin e saktë të traseve, kthesave, lartësive, strukturave mbështetëse dhe elementeve infrastrukturorë. Ky aktivitet hyn në fushën e rielimeve inxhinierike, që sipas VKM 943 kërkon licencë “a” për subjektin apo individin që e kryen. Pa rielime inxhinierike të sakta, asnjë element i projektit konstruktiv ose rrugor nuk mund të zhvillohet, miratohet apo zbatohet.
8-c	Sistemet GIS.	Sisteme GIS për menaxhimin e rrjetit rrugor (të lidhur me ARRSH ose bashkitë) Sisteme për monitorimin e territorit (zhvillim urban, pasuri natyrore)
8-d	Bazamente gjeodezike	Të garantohet që matjet gjeodezike dhe rrjetet referuese të koordinatave realizohen me saktësi dhe standarde të larta, duke siguruar bazën për çdo projekt ndërtimor, infrastrukturor apo hartografik.
9 – d	Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile – ekonomike deri 5 kate.	Bazuar në termat e referencës, për realizimin e Ekspertizave të thelluara nevojitet informacion për karakteristikat gjeologjike të truallit ku ndodhet objekti me qëllim rimodelimin e strukturave, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara. Projekti përfshin ndërtimin e rrugëve ku përfshihen: Shpatë natyrore ose artificiale, Trase që kërkon gërmime, mbushje apo mbrojtje të skajeve me skarpetime. Ka rrezik për rrëshqitje ose deformim të terrenit, ku toka është e lirshme ose ujore. Projekti përfshin ndërtime në zona me qëndrueshmëri të ulët, prandaj kërkohet studim i posaçëm nga subjekt i licencuar në kategorinë “d”, për të garantuar sigurinë e infrastrukturës. Ky studim përcakton: Qëndrueshmërinë e themelimit të shtratit hekurudhor dhe

		Nevojën për masa mbrojtëse, stabilizime me geosintetikë, mure mbajtëse, etj.
9-e	Studime projektive hidrogjeologjike	Projekti kalon në zona me: Nivele të larta ujërash nëntokësorë dhe Lumenj, kanale kullimi, terrene të përmytura sezonalisht. Është e nevojshme të vlerësohet: përhapja e ujërave nëntokësorë dhe Rreziku i nëlagies dhe fundosjes së trupit të rrugës hekurudhore dhe Ndikimi i ndërtimit në shtresat ujëmbajtëse dhe nevoja për drenazh ose mbrojtje ndaj ngritjes së ujërave. Sipas VKM 943, kjo veprimtari kërkon licencë specifike “e” për projektim/studim hidrogjeologjik.
11-a	Projektim sinjalistike jondriçuese në rruge lokale, rruge urbane dytesore, rruge interurbane dytesore, sheshe dhe parkime.	Te sigurojë që projektimi i sinjalistikës rrugore (si tabela, sinjale, shenja horizontale, dhe elementë orientues) bëhet në mënyrë të saktë dhe në përputhje me standardet e sigurisë rrugore, duke ndihmuar në: • Rregullimin e qarkullimit rrugor dhe uljen e aksidenteve, • Orientimin dhe informimin e drejtuesve të automjeteve dhe këmbësorëve, • Përmirësimin e rrjedhshmërisë së trafikut në rrugët lokale dhe urbane, • Sigurimin e një ambienti më të sigurt për përdoruesit e rrugës në zona me intensitet të ndryshëm trafiku.
12 – b	studime /vleresime gjeologo-sizmike për trojet ku ndertohen objektet civile, sociale e kulturore.	Bazuar në termat e referencës, për realizimin e Ekspertizave të thelluara nevojitet informacion për karakteristikat gjeologo-sizmike të rrugëve me qëllim rimodelimin e strukturave, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.

Individët apo personat juridik të cilët disponojnë licenca të cilat nuk janë në përputhje me pikat e Lidhjes 2 “Kategoritë në fushat e studimit dhe projektimit në ndërtim”, të V.K.M. nr. 943, datë 28. 12. 2016, duhet të bëjnë rinovimin dhe ekuivalentimin e tyre. Në rastin e mosparaqitjes së licencave, ofertuesit nuk do të merren në konsideratë për kualifikim. Licencat duhet të jenë të paraqitura dhe të plotësohen nga licenca e subjektit si dhe të gjitha pikat e sipërpërmendura të cilat jepen edhe për individë duhet të përmbushen nga shumatorja e pikave të licencave individuale të stafit inxhinierik.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të kete të punësuar mesatarisht të paktën **5 (pese) punonjës** për periudhën Mars 2025 – Gusht 2025.

Për këtë ofertuesi duhet të paraqesë:

- a)** Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, për periudhën e fundit të deklaruar ,ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin nga muajt e kërkuar;
- b)** Listpagesat e punonjesve të konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit që kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen e fundit te deklaruar, shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetesore.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit permbledhes të vetedeklarimit sipas shtojcës perkatese të DST-se dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatëve të ankimimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit

Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur si më poshtë: për përcaktimin e fuqisë punëtore minimale të kërkuar argumentojme se jemi bazuar në shërbimet e kërkuara sipas Termave të Referencës. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje gjashtë muajt e fundit, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiket të kufizojë edhe problematikën sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të ketë si drejtues teknik të përfshirë në Licensën e Shoqërisë stafin si më poshtë, vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplome, licence profesionale individuale dhe të jenë të përfshirë në Listën e Kontributeve të Sigurimeve Shogjore dhe Shëndetësore dhe TAP, si më poshtë :

- 1 (një) inxhinier ndërtimi
- 1 (një) inxhinier mjedisi,
- 1 (një) inxhinier hidroteknik,
- 1 (një) inxhinier gjeodet,
- 1 (një) inxhinier gjeolog

-a) Për stafin e mesipër operatorët ekonomikë duhet të paraqesin *”Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit të konsulentit”*; (Bazuar në nenin 41 pikë 4/d, të VKM 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, indryshuar, kuparashikohet se: *“Në rastin e prokurimit të shërbimeve me natyrë intelektuale, kundërbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme stafit angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë”*).

-b) Si dëshmi për stafin e mesipër të paraqiten dokumentet si Diploma, Liçencat profesionale personale të projektimit, Kontrata e punës si dhe të figurojnë në Listën e pagesat të punonjësve të shoqërisë për periudhën Mars 2025 – Gusht 2025. Për këtë si dëshmi duhet të dorëzohen listë pagesat përkatëse.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit përmbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-se dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatit të ankimimit.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pikë 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Komisioni për vendosjen e stafit i është referuar Termave të përgjithshme të referencës për objektet pjesë e kësaj procedure, pjesë e secilave do të jenë të licensuar për shërbimet që priten të realizohen. Bazuar në Ligjin nr. 107/2014, i ndryshuar me Ligjin nr. 119/2020, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”; Ligji nr. 8402/1998, i ndryshuar me Ligjin nr. 120/2020, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”; VKM nr. 408, datë

13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”; VKM nr. 943, datë 28.12.2016, për kriteret dhe procedurat e licencimit të profesionistëve në fushën e zhvillimit të territorit; Ligji nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, neni 45, pika 1, shkronja “a”, kërkon që operatorët të demonstrojnë kapacitet teknik dhe profesional të mjaftueshëm.

Në projektet për ndërtimin e rrugëve, që përfshijn:

- Ndërtime sipërfaqësore dhe nëntokësore
- Struktura betoni, metalike dhe ndihmëse
- Impiante elektrike, mekanike, ndriçimi, ujësjellës-kanalizime, drenazhime, etj.
- Studime të specializuara gjeologjike, gjeodezike, hidroteknike

... është detyruesisht e nevojshme që projekti të hartohet nga një staf i plotë multidisiplinar, me përfaqësime profesionale nga çdo fushë.

Profili i kërkuar	Arsyeja teknike
Projektues Gjeodet	Për matje, trasim dhe hartografi teknike
Projektues Gjeolog	Për studime të tokës, kapacitet mbajtës dhe shpate
Projektues Hidroteknik	Për projektimin e kanalizimeve, ujësjellësit, sistemeve të kullimit e mbrojtjes nga ujërat
Inxhinier Ndërtimi	Për hartimin e preventivave, përlogaritjen e sasisë dhe kostos së materialeve
Inxhinier mjedisi	Hartimin e VNM-se. Të vlerësojë dhe minimizojë ndikimet mjedisore të ndërtimit dhe funksionimit të rrugës, duke propozuar zgjidhje të qëndrueshme për mbrojtjen e tokës, ajrit, ujërave dhe biodiversitetit.

- 2.3.5** Operatori ekonomik duhet të ketë stafin ndihmes si me poshte, vertetuar me kontrate pune të vlefshme. diplome, licence profesionale individuale dhe të jene te perfshire ne Listpagesën e Kontributeve te Sigurimeve Shoqerore dhe Shendetesore dhe TAP, te shoqerisë sipas formularit e-sig për periudhen Mars 2025 - Gusht 2025 te deklaruar:
- 1 (nje) Preventivues;

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteri për stafin ndihmes, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës. Nevoja për stafin ndihmes në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për shërbimin e mbikqyrjes së punimeve të zbatimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të shërbimit. Numri i stafit ndihmes është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën

- 2.3.6** Operatori Ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qera:
- 1(nje) Pajisje për matjet gjeodezike GPS;
 - 1(nje) Pajisje për matjet gjeodezike Total Station

Shënim: Operatori ekonomik ofertues në përlogaritjen e ofertes, duhet ti referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik "Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr.354 date

11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim". Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpermendur për bën shkaktim për skualifikim pasi ajo duhet të jetë brenda kufijve të vlerës minimale dhe maksimale të lejuar në kuptim të nenit 7/1 të VKM nr. 354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin e territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim".

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, pajisjet topografike e asete të tjera fizike, aftësitë organizative etj. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave. *Pajisje e mësipërme është e nevojshme për të realizuar matjet në vend dhe nxjerrjen e të dhënave gjatë dhe për hartimit të projektit.* Pajisje GPS është kërkuar pasi është i domosdoshëm për procesin e rievimit të të rrugëve, Pajisje Total Station, është kërkuar pasi është i nevojshëm sidomos për projektet e rrugëve, hartimin e profilave tërthorë e gjatësorë.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Referuar procesverbalit nr 3155 prot date 08.09.2025 janë hartuar në varësi të objektit të kontratës nga Komisioni i hartimit të fondit limit, specifikimeve teknike dhe kriterëve të vecanta të kualifikimit krijuar me Urdhër. Nr. 3080 datë 28.08.2025 ku bashkëlidhur ka dërguar kriteret e vecanta të kualifikimit, preventivin, specifikimet teknike të dërguara, terma reference dhe detyrë projektimi plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 36 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin publik", dhe nenin 40 pika 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik" (i ndryshuar). *Specifikimet teknike, të hartuara për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë elementet më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, dhe çdo standard të kërkuar, referuar kërkesave dhe standarteve ndërkombëtare për automjetet.*

Njesia e prokurimit publik:

Komisioni i hartimit të kriterëve të vecanta :